



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 183, Datë 13.07.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E “BURSËS SHQIPTARE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX” SH.A. NË VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË
TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “f”, nenit 5, pika 1, gërma “f”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19 pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 1118/5prot., datë 13.07.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 966 prot., datë 27.06.2022, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.
- “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., është krijuar bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; VKM- së nr. 609, datë 11.09.2019 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e operatorit të tregut”. Kjo shoqëri do të operojë në tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe ka hapur degën e saj edhe në Kosovë, sipas VKM-së nr. 1, datë

27.01.2021 “Për miratimin e hapjes së Degës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në Kosovë”.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “c” dhe “e”.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “b” “c” dhe “d”.
 - Dokumentacioni tekniko-ekonomik për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.9, gërmat “a”, “b”, “d”, “f” dhe “g”.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar ose plotësuar pjesërisht, si vijon:

Dokumentacioni juridik dhe administrativ

Neni 9, pika 2:

- **gërmat “a”/“b”** Shoqëria duhet të sqarojë mungesën e Aktit të Themelimit.
- **gërma “d”** Duhet të depozitohen në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për shoqërinë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e shlyerjes së tatimeve.

4.9 Dokumentacioni tekniko- ekonomik për licencimin e veprimtarisë së Operimit të Tregut të energjisë elektrike

- **gërma “c”** Në rast licencimi, shoqëria duhet të përcjellë në ERE informacion shtesë periodik mbi implementimin e këtij harduerit dhe softuerit / platformave, siç parashikuar në kontratën përkatëse, për të kryer të gjitha operacionet e bursës.
- **gërma “e”** Në lidhje me dëshminë që vërteton mundësinë për të zhvilluar të gjitha procedurat operacionale, kontraktuale ose marrëdhëniet e aksesit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE

mekanizmat e saj për mbikëqyrjen e tregut, procedurat dhe kontrollet për mbrojtjen e informacionit konfidencial.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI